



Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

ARSIMI PROFESIONAL

KURRIKULA

Bërthamë

Programi pilot për kualifikimin e Profilit

Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit

Në Lëminë “Hoteleri”

Niveli 3 dhe 4 i Kornizës së Kualifikimeve të Kosovës

Shkalla 5 dhe 6 e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës

Niveli I dhe II i Arsimit Profesional

Klasa 10,11 dhe 12

Ky dokument është zhvilluar me mbështetje financiare nga Projekti i Aleancës së Ballkanit Perëndimor për Mësim të bazuar në punë, i financuar nga Agjensia Austriake e Zhvillimit me fonde nga Bashkëpunimi Austriak i Zhvillimit – Drejtë Standardeve Rajonale të Profesioneve – TO REGOS

Kosovë, qershor 2021

Parathënie

I. Kurrikula bërthamë për profilin “Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit”, klasat 10, 11 dhe 12

- 1. Njoftime të përgjithshme për profilin “Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit”, klasat 10-12.**
 - a. Struktura e shkollimit dhe certifikimi.
 - b. Kërkesat e pranimi të nxënësve.
 - c. Mundësitë e shkollimit të mëtejshëm dhe të punësimit.
 - d. Qëllimet e përgjithshme të shkollimit.
 - e. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve.
 - f. Kompetencat profesionale të nxënësve.
- 2. Plani mësimor i profilit “Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit”, klasat 10-12.**
- 3. Udhëzime për zbatimin e kurrikulës bërthamë.**
- 4. Përshkruesit e moduleve profesionale**
 - a. Përshkruesit e moduleve profesionale të klasës së 10
 - b. Përshkruesit e moduleve profesionale të klasës së 11
 - c. Përshkruesit e moduleve profesionale të klasës së 12-të

I. Parathënie

II. Kurrikula bërthamë për profilin “Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit”, klasat 10-12

1. Njoftime të përgjithshme për profilin “Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit”, klasat 10-12

a) Struktura e shkollimit dhe certifikimi.

Arsimimi në profilin mësimor “Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit” trajtohet në kuadrin e shkollimit të mesëm të lartë dhe ofrohet në Shkollat e Mesme të Larta Profesionale të Hotelierisë, në dy nivele:

- *niveli i parë* i arsimit profesional, me kohëzgjatje 2 vite mësimore (kl.10-të dhe 11-të) i përgatit nxënësit për nivelin fillestar (hyrës) të punësimit në profesionin e “Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit”. Në përfundim të këtij niveli nxënësit fitojnë certifikatën e nivelit të parë të arsimit profesional.
- *niveli i dytë*, i arsimit profesional, me kohëzgjatje një vit mësimor (klasa 12-të) pas përfundimit të nivelit të parë, i përgatit nxënësit për të fituar një kualifikim profesional në profilin “Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit”, që u mundëson atyre integrimin në tregun e punës si dhe vazhdimin e studimeve në nivele më të larta. Në përfundim të këtij niveli nxënësit fitojnë diplomë e nivelit të dytë të arsimit profesional.

Ky dokument përmban kurrikulën bërthamë të profilit “Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit”, për nivelin e I të Arsimit Profesional, dhe është i strukturuar në:

- A. Lëndë të kulturës së përgjithshme (programet e tyre jepen në një dokument të veçantë të Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - MASHT) të cilat synojnë formimin e përgjithshëm të nxënësve.
- B. Module profesionale, përshkruesit e të cilëve jepen në këtë dokument. Këto module synojnë përgatitjen e nxënësve me kompetencat profesionale të nevojshme për t’u integruar me sukses në tregun e punës.

b) Kërkesat e pranimit të nxënësve.

Shkollimin në profilin “Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit”, niveli I, mund ta ndjekin të gjithë të rinjtë dhe të rejat të cilët kanë përfunduar me sukses arsimin e detyruar nëntëvjeçar, janë në moshë deri 21 vjeç dhe zotërojnë aftësi shëndetësore (fizike e mendore) të mjaftueshme për të kryer këtë nivel shkollimi.

Në raste të veçanta, kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se sa kapacitetet reale të shkollave profesionale, MASHTI përgatit udhëzime të veçanta me kriteret pranimi të posaçme për këto shkolla.

c) Mundësitë e shkollimit të mëtijshëm dhe të punësimit

Përfundimi me sukses i shkollimit për profilin “Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit”, niveli I (kl.10-11), i lejon nxënësve vazhdimin e shkollimit në nivelin II (kl.12) të po këtij profili.

Shkollimi në profilin “Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit”, niveli I, i referohet veprimtarive profesionale që kryhen në profile të ndryshme profesionale që i përkasin sektorit të Hotelierisë.

Nisur nga kjo, nxënësi që përfundon me sukses shkollimin në profilin “Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit”, niveli I, mund të punësohet në kompani dhe institucione publike dhe private të cilat e kanë të domosdoshme kryerjen e veprimtarie profesionale përkatëse.

d) Qëllimet e përgjithshme të shkollimit.

Qëllimi kryesor i shkollimit në profilin “Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit”, niveli I, është zhvillimi i personalitetit të nxënësve për t’u përfshirë në një shoqëri demokratike si qytetarë aktiv dhe kompetent, si dhe për t’u angazhuar me sukses në tregun e punës gjithnjë në ndryshim. Sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi janë dhe zhvillimi i ndjenjës së vet-besimit të nxënësit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e

vendimeve, nxitja e gatishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t'u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe profesionale.

Për të realizuar këto qëllime, është e nevojshme që Shkollat Profesionale të mesme të larta t'u krijojnë nxënësve:

- Mundësi të përshtatshme për të nxënë pavarësisht nga gjinia, raca, etniteti dhe aftësitë fizike e mendore;
- Mundësi për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet dhe qëndrimet/vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e aftësitë profesionale të mëtejshëm;
- Kushte për të njohur dhe zbatuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Kushte për t'u njohur me teknologjitë dhe proceset e punës aktuale e të perspektivës, në sektorin e ekonomisë;
- Lehtësi për të kuptuarit e mjedisit shoqëror dhe ekonomik, lokal, kombëtar dhe rajonal, si dhe për të qenë të vetëdijshëm për rolin që mund të luajnë në këtë mjedis.
- Mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe vlerat morale;
- Kushte për t'u zhvilluar psikikisht, emocionalisht dhe fizikisht, për të përballuar sfidat dhe vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale.
- Kushte për tu vlerësuar drejt dhe me realizëm në lidhje me potencialin dhe arritjet e tyre;
- Mbështetje për të marrë përgjegjësi në procesin e zhvillimit të tyre të vazhdueshëm personal dhe profesional.
- Mbështetje për të zhvilluar format e bashkëpunimit dhe të besimit të ndërsjellë nëpërmjet përvojës së punës praktike.
- Mundësi për t'u njohur me zhvillimet perspektive të profesionit të tyre, të para këto në kontekstet e integritit rajonal dhe Evropian.

e) Kompetencat e përgjithshme të nxënësve.

Ndjekja e shkollimit në profilin "Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit", niveli I, do të zhvillojë te nxënësit një tërësi kompetencash të përgjithshme të cilat do t'i shërbejnë atij në përvetësimin me efektivitet të programit mësimor, si bazë për zhvillimin në nivelin e kërkuar të kompetencave profesionale, vijimin e shkollimit të mëtejshëm, si dhe integrimin e suksesshëm në shoqëri dhe në tregun e punës gjithnjë në ndryshim. Kështu, nxënësi do të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte, me shkrim dhe me gojë, për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të komunikojë dhe të përdorë burime të ndryshme informacioni në gjuhë të huaj.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme (përfshirë ato të kompjuterizuara) të mbledhjes dhe shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të menaxhojë dhe përdorë me efektivitet burimet në dispozicion në funksion të përmbushjes së objektivave.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në marrjen e vendimeve për zgjidhjen e situatave të ndryshme problemore në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të manifestojë vetëbesim dhe qasje të një kritike konstruktive ndaj zhvillimeve profesionale, personale dhe shoqërore.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm për kërkim të vazhdueshëm në drejtim të zgjidhjeve të reja, më efektive.
- Të zbatojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale, rajonale dhe globale.
- Të tregojë guxim dhe iniciativë në marrjen e përgjegjësisë për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vet-kontroll dhe pavarësi në vendim-marrje në ushtrimin e veprimtarive të tij.

- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gatishmërinë e vullnetin për një të nxënë që zgjat gjithë jetën.
- Të zbatojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të përbashkëta.
- Të vet-orientohet drejt për karrierën e punësimit dhe shkollimit të mëtejshëm.
- Të vlerësojë dhe vetë-vlerësojë nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej të arriturat.

f) Kompetencat profesionale të nxënësve.

Ndjekja e shkollimit në profilin “Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit”, niveli I, do të zhvillojë te nxënësit edhe një tërësi kompetencash profesionale të cilat do t’i shërbejnë atij për vijimin e shkollimit dhe të aftësisimit profesional të mëtejshëm, si dhe për punësimin e suksesshëm në sektorin e Hotelierisë. Kështu, nxënësi do të jetë i aftë:

- Të ndërmer veprimet në sektorin e ushqimit dhe pijeve në ndërmarrjet hotelier – restorantore
- Të bëjë organizimin e ndërmarrjes hoteliere
- Të koordinojë punën e receptionit, restorantit dhe shërbimeve të pastrimit e mirëmbajtjes
- Të bëjë pritjen, pranimin dhe akomodimin e klientëve në strukturën e mikpritjes
- Të informojë dhe rekomandojë klientët për ofrimin e shërbimeve shtesë në hotel dhe restaurant
- Të bëjë shitjet dhe rezervimet e akomodimit dhe shërbimeve shtesë në hotele dhe restaurant
- Të organizoj eventet dhe kateringun
- Të bëjë cregjistrimin (check-out) dhe shoqërimin r klientëve nga hoteli dhe restaurant
- Të sigurojë sigurim të cilësisë në ndërmarrjet hoteliere -restorantore
- Të komunikoj në mënyrë profesionale dhe etike në hotelieri – restorant
- Të kryejë detyrat administrative në ndërmarrjet hoteliere-restorantore
- Të kryejë detyrat tregtare në ndërmarrjet hoteliere – restorantore
- Të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

2. Plani mësimor i profilit “Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit”, klasat 10-12

| SHKOLLA E MESME E LARTË PROFESIONALE- NIVELI III dhe IV I KUALIFIKIMIT, SIPAS KKK | | | | | | |
|---|---------------------|------------------------|----------|-----------|----------|-------|
| LËMITË ARSIMORE | EKONOMI | | | | | |
| | ADMINISTRATË | | | | | |
| | HOTELERI | | | | | |
| | TURIZËM | | | | | |
| FUSHA KURRIKULARE | Lëndët mësimore | Fondi i orëve mësimore | | | | |
| | | Shkalla 5 | | Shkalla 6 | Gjithsej | % /FK |
| | | Klasa 10 | Klasa 11 | Klasa 12 | | |
| Gjuhë dhe komunikim | Gjuhë amtare | 3 | 3 | 3 | 9 | 16,6 |
| | Gjuhë angleze | 2 | 2 | 2 | 6 | |
| | Gjuhë e dytë e huaj | 0 | 0 | 1 | 1 | |
| Artet | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Matematika | Matematikë | 2 | 2 | 2 | 6 | 6,25 |
| Shkencat natyrore | Fizikë | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Kimi | 0 | 0 | 0 | 0 | |

| | | | | | | |
|--------------------------------------|---|----|---|----|----|------|
| | Biologji | | | | 0 | |
| | Gjeografi | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| Shoqëria dhe mjedisi | Edukatë qytetare | 1 | 0 | 0 | 1 | 1 |
| | Histori | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| | Psikologji | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| Shëndeti dhe mirëqenia | Edukatë fizike dhe shëndetësore | 2 | 2 | 2 | 6 | 6,25 |
| | | 10 | 9 | 10 | 29 | |
| Jeta dhe puna | TIK | 1 | 1 | 1 | 3 | 3,1 |
| | Ndërmarrësi | 1 | 1 | 1 | 3 | 3,1 |
| | Bazat e turizmit | 4 | | | | |
| | Gjeografike turistike | 2 | | | | |
| | Mbrojtja në vendin e punës dhe mbrojtja e mjedisit në ndërmarrjet hoteliere - restorantore | 2 | | | | |
| | Veprimet në sektorin e ushqimit dhe pijeve në ndërmarrjet hotelier - restorantore | 5 | | | | |
| | Organizimi i ndërmarrjes hoteliere | 3 | | | | |
| | Komunikimi në hoteleri - restoran | 3 | | | | |
| | Detyrat administrative në ndërmarrjet hoteliere-restorantore | | 4 | | | |
| | Koordinimi i punës se recepsionit, restorantit dhe shërbimeve të pastrimit e mirëmbajtjes | | 5 | | | |
| | Pritja, pranimi dhe akomodimi i klientëve ne strukturën e mikpritjes | | 5 | | | |
| | Informimi dhe rekomandimi i klientëve për ofrimin e shërbimeve shtesë në hotel dhe restaurant | | 3 | | | |
| | Marketing turistik | | 3 | | | |
| | Detyrat tregtare në ndërmarrjet hoteliere - restorantore | | | 3 | | |
| | Shitjet dhe rezervimet e akomodimit dhe shërbimeve shtesë në hotele dhe restorante | | | 3 | | |
| Organizimi i eventeve dhe kateringut | | | 3 | | | |

| | | | | | | |
|-----------------|--|-----------|-----------|-----------|-----------|------------|
| | Çregjistrimi (check-out) dhe shoqërimi i klientëve nga hoteli dhe restoranti | | | 2 | | |
| | Sigurimi i cilësisë në ndërmarrjet hoteliere - restorantore | | | 2 | | |
| | Firmat ushtrimore | | | 6 | | |
| Pjesa zgjedhore | Gjuhë Gjermane aplikative 1 | | | | | |
| | Gjuhë Gjermane aplikative 2 | | | | | |
| | Estetika dhe shërbimet speciale në restorant dhe bar | | | | | |
| | Shërbimi në pritje dhe bankete | 1 | 1 | 1 | 1 | |
| | Somolier i verërave (degustator) | | | | | |
| | Trashëgimia kulturore dhe historike | | | | | |
| Gjithsej | | 32 | 32 | 32 | 96 | 100 |

Shënim: Viti shkollor ka 35 javë në vit dhe një javë mësimore ka 32 orë.

3. Udhëzime për zbatimin e kurrikulës bërthamë.

- Në Shkollat e Mesme Profesionale, përgatitja profesionale e nxënësve realizohet me anë të “moduleve profesionale”, të cilët janë me përmbajtje teorike - praktike. Në Planin mësimor të Kurrikulës bërthamë tregohet lista e moduleve profesionale të cilët janë të detyrueshëm të zbatohen dhe nuk mund të ndryshohen nga Shkollat e Mesme Profesionale.
- Kurrikula bërthamë përmban “përshkruesit e moduleve profesionale”, të cilët duhet të zhvillohen dhe të detajohen më tej nga vetë mësuesit e Shkollat e Mesme Profesionale. Gjatë përgatitjes së programeve mësimore të hollësishme, mësimdhënësit duhet të kenë parasysh që, për çdo modul profesional, *Rezultatet Mësimore* dhe *Kriteret e Vlerësimit* të nxënësve janë të detyrueshme dhe nuk mund të ndryshohen prej tyre. Ndërsa përmbajtjet e rubrikave të tjera të moduleve profesionale janë *rekomanduese* dhe mund të përshtaten nga vetë mësimdhënësit në përputhje me zhvillimet më të fundit në profesionet përkatëse dhe kushtet konkrete për zbatimin e moduleve.
- Edhe nëse modulet profesionale do të trajtohen nga mësimdhënësit të veçantë, gjatë përgatitjes së programeve mësimore të hollësishme dhe gjatë zbatimit të tyre duhet të ketë një *bashkëpunim* të ngushtë të gjithë ekipit të mësimdhënësve që trajtojnë modulet profesionale të kualifikimit profesional përkatës.
- Për modulet profesionale, si njësi matëse e ngarkesës mësimore do të përdoret koncepti i *Kredisë*, ku një Kredi është i barazvlefshëm me 10 orë mësimore, dhe ku një orë mësimore ka një kohëzgjatje prej 45 minutash.
- Përmbushja me sukses e moduleve profesionale kërkon *integrimin e teorisë me praktikën* e profesionit dhe për këtë, parimi i “*të nxënësve duke bërë*” duhet të zbatohet gjerësisht në procesin mësimor.
- Njohja e vazhdueshme e nxënësve me Rezultatet e të Mësuarit që përmbajnë përshkruesit e moduleve si dhe me Kriteret e Vlerësimit përkatëse, ndihmon në nxitjen e *motivimit* të nxënësve dhe lehtëson përvetësimin e kompetencave profesionale.
- Mësimdhënësit e moduleve profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimore të tilla që të fuqizojnë maksimalisht të nxënësve aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ata të kompetencave sociale e profesionale, të plota dhe të qëndrueshme.

- Rekomandohet që mësime të moduleve profesionale të përdorin metoda mësimore që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe sjelljet dhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. Metoda e *punës në grup* duhet të jetë në themel të organizimit të mësimit teorik dhe praktik për të zhvilluar te nxënësit *kompetencat profesionale*, të nevojshme për të përballuar me sukses vështirësitë që kanë të bëjnë me veprimtarinë e ardhshme profesionale, me vazhdimin e shkollimit të mëtejshëm, si dhe me veprimtarinë shoqërore si qytetar i një shoqërie demokratike.
- Një parim tjetër që duhet të zbatohet nga mësime të moduleve profesionale është që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave, puna hulumtuese dhe studimet e rastit të nxënësve kanë një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm.
- Rekomandohet që në trajtimin e Rezultateve Mësimore teorike të moduleve të përdoren metoda të tilla si *ligjërrata, dhënia e shembujve, zgjidhja e problemit teorik, dhënia e detyrave* etj. Ndërsa në trajtimin e Rezultateve Mësimore praktike të përdoren kryesisht *demonstrimi nga mësime të nxënësve, praktika e mbikëqyrur dhe praktika e pavarur e nxënësve*.
- Mësime të moduleve profesionale duhet të respektojnë *individualitetin* e nxënësve duke nxitur përparimin e shpejtë të nxënësve të përparuar dhe duke mbështetur nxënësit e prapambetur me veprimtari mësimore te veçanta.
- Në kushtet e mungesës së mjediseve reale të punës për praktikimin e nxënësve, rekomandohet që në Shkollat e Mesme Profesionale të krijohen *mjedise të simuluar të punës*.
- Shkollat e Mesme Profesionale duhet të krijojë *lidhje të ngushta me bizneset lokale* që kryejnë veprimtari në kualifikimet profesionale përkatëse, për të mundësuar praktikimin e nxënësve dhe marrjen e informatave për zhvillimet në profesionet përkatëse.
- Përsa i përket *vlerësimit të nxënësve*, rekomandohet të përdoren metoda dhe instrumente vlerësimi që nxisin krijimin e kompetencave të nxënësve, shmangin subjektivizmin në vlerësim dhe tregojnë arritjet reale të tyre. Me rëndësi është vlerësimi i *vazhdueshëm* dhe ai *përfundimtar*, ku format, metodat dhe instrumentet e vlerësimit përzgjidhen apo hartohen nga vetë mësime të nxënësve. Duhet të synohet vlerësimi i arritjeve *i bazuar në kriteret* (ku arritjet e nxënësve krahasohen me standardet e paracaktuara) dhe të shmangët sa më shumë të jetë e mundur *vlerësimi i bazuar në renditjen* (ku nxënësit krahasohen me njëri-tjetrin). Metodat dhe instrumentet e vlerësimit që rekomandohen janë: pyetjet – përgjigjet me gojë, pyetjet - përgjigjet me shkrim, detyrat me shkrim, vëzhgimi i veprimtarisë së nxënësve, listat e kontrollit të veprimtarive praktike dhe të produkteve të punës, projekte për vlerësimin etj.
- *Lista e kontrollit* duhet të jetë instrumenti bazë për vlerësimin e shprehive praktike të nxënësve, të testuara në situata pune reale apo të simuluar.
- Mësime të nxënësve duhet të përgatisin *Instrumentet e vlerësimit të nxënësve për çdo Rezultat Mësimor të paraqitur në përshkruesit e moduleve profesionale*, duke u bazuar në Kriteret e vlerësimit përkatëse.
- Në rastin e nxënësve me *aftësi të kufizuara*, mësuesit duhet të përshtatin programet e hollësishme të moduleve profesionale në përputhje me mundësitë fizike të këtyre nxënësve, si dhe të krijojnë kushte të përshtatshme për zbatim.
- Në përgjithësi, si për procesin mësimor, ashtu edhe për vlerësimin e nxënësve, duhet të synohen forma dhe metoda që e vendosin *nxënësin në qendër* të veprimtarive mësimore dhe e shndërrojnë rolin e mësime të nxënësve nga një lektor i thjeshtë, në një organizator, mbikëqyrës, nxitës dhe vlerësues i veprimtarisë së nxënësve.

4. Përshkruesit e moduleve profesionale

a) Përshkruesit e moduleve profesionale të klasës së 10-të.

**PËRSHKRUESI I MODULIT
TEKNOLOGJI INFORMATIVE DHE TELEKOMUNIKACIONIT (TIK)
Klasa 10**

Titulli i Kualifikimit: Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit

Vlera e Kredive të Modullit: 3 Kredi (35 orë mësimore) në Nivelin 3 të KKK

Niveli i Modullit në KKK: Niveli 3 i KKK

Niveli i Modullit në Strukturën Arsimore: Niveli I i AP

Rezultatet Mësimore (RM) të Modullit: Teknologji informative dhe telekomunikacionit (TIK), klasa 10:

RM1: Nxënësi përdor bazat e teknologjisë informative.

RM2: Nxënësi mirëmban harduerin dhe softuerin e kompjuterit personal.

RM3: Nxënësi shfrytëzon internetin.

RM4: Nxënësi shfrytëzon softuerin aplikativ.

RM1: Nxënësi përdor bazat e teknologjisë informative

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë të:

- Përshkruajë konceptet themelore në teknologjinë informative;
- Përshkruajë përdorimin e teknologjisë informative në fusha të ndryshme dhe në shoqëri;
- Dallojë komponentet themelore të sistemit kompjuterik;
- Përshkruajë komponentet harduerike dhe softuerike të kompjuterit personal;
- Tregojë rolin e pajisjeve qendrore dhe periferike të kompjuterit personal;
- Përkufizojë ergonominë në përdorimin e kompjuterit;
- Manipulojë me dritaret e sistemit operativ windows;
- Rregullojë parametrat e windowsit;
- Menaxhojë me dokumente dhe programe në windows;
- Menaxhojë me foldera dhe fajlla me ndihmën e sistemit operativ windows;
- Përshkruajë masat mbrojtëse në punë.

Kushtet e nevojshme:

- Laboratori.
- Tabela.
- Projektori.
- Kompjuterë.
- Materiale të nevojshme (materiale të shkruara, katalogje etj.).
- Listat e të dhënave.
- Materiale konkretizimi si: (pllaka amë, kartela të ndryshme, furnizuesi i rrymës, procesori, memorie, hard disk etj).
- Qasja në internet etj.

Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:

- Përshkruan konceptet themelore në teknologjinë informative;
- Përshkruan përdorimin e teknologjisë informative në fusha të ndryshme dhe në shoqëri;
- Dallon komponentet themelore të sistemit kompjuterik;

- Përshkruan komponentet harduerike dhe softuerike të kompjuterit personal;
- Shpjegon rolin e pajisjeve qendrore dhe periferike të kompjuterit personal;
- Zbaton ergonomimin në përdorimin e kompjuterit;
- Manipulon me dritaret e sistemit operativ windows;
- Rregullon parametrat e windowsit;
- Menaxhon me dokumente dhe programe në windows;
- Menaxhon me foldera dhe fajlla me ndihmën e sistemit operativ windows;
- Paraqet shkathtësi për masa mbrojtëse në punë.

Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësi:

- Identifikon pajisjet qendrore, hyrëse dhe dalëse të kompjuterit;
- Demonstron përdorimin e dritareve në windows;
- Demonstron krijimin e fajllave/folderëve;
- Demonstron veprime (riemërtimin, kopjimin, bartjen etj.) me fajlla/foldera;
- Ndërmerr iniciativë për hulumtimin e njohurive të reja;
- Zbaton masat mbrojtëse.
- Shpjegon konceptet themelore në teknologjinë informative.
- Shpjegon përdorimin e teknologjisë informative në fusha të ndryshme dhe në shoqëri.
- Tregon ndërtimin dhe mënyrën e funksionimit të kompjuterit.
- Shpjegon komponentet themelore të kompjuterit (harduerin dhe softuerin).
- Shpjegon rolin e pajisjeve qendrore dhe periferike të kompjuterit personal.
- Shpjegon përdorimin e windowsit.
- Tregon rregullimin e parametrave të windowsit.
- Tregon punën me programe dhe dokumente në windows.
- Tregon punën me fajlla dhe folderë në windows.
- Shpjegon masat mbrojtëse në punë.

Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:

- Komunikimi.
- Bashkëpunimi.
- Iniciativë për hulumtimin e njohurive të reja.
- Mbledh dhe përpunon informata.
- Të menduarit logjik.
- Shkathtësi në zgjidhjen e problemeve.
- Të jetë kritik dhe konstruktiv.
- Punë në grup.

Kërkesat për vlerësimin e nxënësve:

- Pyetje - përgjigje me shkrim.
- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Listë kontrolli.
- Informata kthyesë.
- Teknika e vrojtimit.
- Detyra të shtëpisë.

Evidentimi i Vlerësimit:

- Testi me shkrim duhet të përmbajë pyetje me përgjigje të mbyllur për të verifikuar shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kriterëve të vlerësimit.
- Testi me shkrim, kombinim i pyetjeve me përgjigje të përputhshme, me përgjigje të shumëfishtë ose me përgjigje të shkurtër.
- Pyetjet me gojë duhet të jenë me përgjigje të hapura.
- Lista e kontrollit duhet të verifikojë aftësinë e nxënësit që të dallojë pajisjet e jashtme dhe të brendshme, pajisjet hyrëse-dalëse, lexojnë shënimet në pajisjet e ndryshme, lexojnë performansat e kompjuterit, etj.

RM2: Nxënësi mirëmban harduerin dhe softuerin e kompjuterit personal

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë të:

- Dallojë komponentët harduerike;
- Identifikojë problemet në pajisjet qendrore dhe periferike të kompjuterit personal;
- Rregullojë gabimet në softuerin (drajverët) e pajisjeve qendrore dhe periferike të kompjuterit personal;
- Ndërrojë pajisjet qendrore dhe periferike të kompjuterit personal;
- Identifikojë dhe rregullojë gabimet softuerike të kompjuterit personal;
- Demonstrojë instalimin e programeve aplikative;
- Demonstrojë instalimin e sistemit operativ (aktualisht, SO Windows);
- Tregojë procedurat për formatizim;
- Përditësojë sistemin operativ;
- Përdorë masat mbrojtëse në punë.

Kushtet e nevojshme:

- Laborator.
- Tabela.
- Projektori.
- Kompjuterë.
- Materiale të nevojshme (materiale të shkruara, katalogje, DVD me sisteme operative, softuerët sistemor etj.).
- Listat e të dhënave.
- Qasja në internet etj.

Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:

- Dallon dhe identifikon pajisjet harduerike;
- Identifikon natyrën e gabimeve të pajisjeve harduerike;
- Zgjidh problemet e paraqitura në pajisjet harduerike;
- Klasifikon gabimet softuerike;
- Zgjidh problemet e paraqitura softuerike;
- Përshkruan procedurat e instalimit të programeve aplikative;
- Përshkruan procedurat e instalimit të sistemeve operative;
- Tregon procedurat për formatizimin dhe ndarjen e hard diskut;
- Punon në nivel bazë me sistemet operativ WINDOWS (por mundet edhe me sistemet operative si: UNIX, LINUX).

Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësi:

- Zëvendson dhe identifikon pajisjet harduerike;
- Identifikon natyrën e gabimeve të pajisjeve harduerike;
- Zgjidh problemet e paraqitura në pajisjet harduerike;
- Klasifikon gabimet softuerike;
- Zgjidh problemet e paraqitura softuerike;
- Demonstron instalimin e programeve aplikative;
- Demonstron instalimin e sistemeve operative;
- Zbaton procedurat për formatizimin dhe ndarjen e hard diskut;
- Punon në nivel bazë me sistemet operativ WINDOWS (por mundet edhe me sistemet operative si: UNIX, LINUX).
- Klasifikon pajisjet harduerike.
- Shpjegon metodat e identifikimit dhe zgjidhjes së problemeve harduerike.
- Shpjegon metodat e zëvendësimit të pajisjeve harduerike.

- Shpjegon natyrën e gabimeve softuerike.
- Shpjegon metodat e zgjidhjes së problemeve softuerike.
- Tregon hapat e instalimit të programeve aplikative.
- Tregon procedurën e instalimit të sistemit operativ.
- Shpjegon procedurën për formatizimin e hard diskut.
- Shpjegon masat mbrojtëse në punë.

Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:

- Komunikimi.
- Bashkëpunimi.
- Diskutim.
- Iniciativë për hulumtimin e njohurive të reja.
- Mbledh dhe përpunon informata.
- Të menduarit logjik.
- Shkathtësi në zgjidhjen e problemeve.
- Të jetë kritik dhe konstruktiv.
- Punë në grup.
- Punë në dyshe etj.

Kërkesat për vlerësimin e nxënësve:

- Pyetje - përgjigje me shkrim.
- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Listë kontrolli.
- Informata kthyese.
- Teknika e vrojtimit.
- Prezantime te detyrave të ndryshme.

RM3: Nxënësi shfrytëzon internetin

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit - Nxënësi duhet të jetë i aftë të:

- Shpjegojë internetin dhe WWW (World Wide Web);
- Numërojë shërbimet në internet;
- Numërojë aplikacionet e shfletuesit të WEB-it (WEB browser);
- Përshkruajë përdorimin e Web browser-eve të ndryshëm;
- Tregojë përparësitë e shfrytëzimit të postës elektronike;
- Përshkruajë dërgimin dhe pranimin e E-mail mesazhit duke shfrytëzuar aplikacione të ndryshme;
- Përshkruajë përdorimin e E-mail (duke përdorur serviset si: gmail, hotmail, outlook);
- Shfrytëzojë bisedat e drejtpërdrejta;
- Shfrytëzojë kërkimin e informacioneve;
- Tregojë organizimin e faqeve në internet;
- Përshkruajë opsionet Doënlod dhe Upload;
- Përshkruajë opsionet E-Learning, E-Banking, Blerjet Online;
- Përshkruajë teknikat e mbledhjes të informatave nga aplikacioni i Web-it.

Kushtet e nevojshme:

- Kabineti i informatikës.
- Tabela.
- Projektori.
- Kompjuterë.
- Materiale të nevojshme (materiale të shkruara, katalogje etj.).
- Listat e të dhënave.

| |
|---|
| <ul style="list-style-type: none"> - Qasja në internet etj. |
| <p>Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshkruan internetin dhe WWW (World Wide Web); - Numëron shërbimet në internet; - Tregon hulumtimin (navigimin) nëpër internet; - Numëron aplikacionet e shfletuesit të WEB-it (WEB browser); - Tregon përparësitë e shfrytëzimit të postës elektronike; - Përshkruan dërgimin dhe pranimin e E-mail mesazhit; - Përshkruan organizimin e E-mail aplikacionit; - Tregon opsionet Doënlod dhe Upload; - Tregon shërbimet E-Learning, E-Banking, Blerjet Online. |
| <p>Shkathhtësitë që përvetësohen nga nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Demonstron përdorimin e E-mail aplikacionit; - Shfrytëzon bisedat e drejtpërdrejta; - Demonstron përdorimin e Web browser-eve të ndryshëm; - Shfrytëzon kërkimin e informacioneve; - Zbaton organizimin e faqeve në internet; - Demonstron Doënlod dhe Upload; - Demonstron E-Learning, E-Banking dhe Blerjet Online; - Demonstron mbledhjen e informatave nga aplikacioni i Web-it (WWW). - Përshkruan internetin dhe WWW (World Wide Web). - Tregon shërbimet në internet. - Përshkruan aplikacionet e shfletuesit të WEB-it (WEB browser). - Përshkruan përparësitë e shfrytëzimit të postës elektronike. - Përshkruan dërgimin dhe pranimin e E-mail mesazhit duke shfrytëzuar aplikacione të ndryshme. - Tregon përdorimin e E-mail (duke përdorur shërbimet si: gmail, hotmail, outlook). - Tregon funksionimin e video konferencave. - Tregon funksionimin e Doënlod dhe Upload. - Tregon funksionimin e: E-Learning, E-Banking dhe Blerjet Online. |
| <p>Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi. - Bashkëpunimi. - Diskutim. - Iniciativë për hulumtimin e njohurive të reja. - Mbledh dhe përpunon informata. - Të menduarit logjik. - Shkathhtësi në zgjidhjen e problemeve. - Të jetë kritik dhe konstruktiv. - Punë në grup. - Punë në dyshe. - Punë individuale etj. |
| <p>Kërkesat për vlerësimin e nxënësve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje - përgjigje me shkrim. - Pyetje - përgjigje me gojë. - Listë kontrolli. - Informata kthyesë. - Teknika e vrojtimit. - Prezantime të ndryshme. |

RM4: Nxënësi shfrytëzon softuerin aplikativ

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit - Nxënësi duhet të jetë i aftë të:

- Përshkruajë softuerin aplikativ;
- Përkufizojë kuptimin dhe përdorimin e softuerit për përpunim të tekstit;
- Përshkruajë përpunimin, modifikimin dhe formatizimin e tekstit;
- Tregojë krijimin, përpunimin dhe shtypjen e dokumentit në letër;
- Tregojë kompetencë në përdorimin e disa veçorive më të avancuara në dokument;
- Përshkruajë softuerin aplikativ për prezantim;
- Përshkruajë krijimin, formatizimin dhe dizajnimin e sllajdeve;
- Tregojë aftësi për kryerjen e operacioneve themelore me grafikë dhe diagrame;
- Prezantojë sllajde të punuara sipas rregullave estetike;
- Përkufizojë kuptimin dhe përdorimin e softuerin për tabela;
- Përkufizojë formula dhe funksione të ndryshme;
- Përshkruajë librin e punës (Eörkbook), fletat punuese (sheets) dhe editimin e të dhënave;
- Përshkruajë adresimin relativ dhe absolut;
- Përshkruajë shtypjen e librit punues në letër.

Kushtet e nevojshme:

- Kabineti.
- Tabela.
- Projektori.
- Kompjuterë.
- Materiale të nevojshme (materiale të shkruara, katalogje etj.).
- Listat e të dhënave.
- Qasja në internet etj.

Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:

- Përshkruan softuerin aplikativ;
- Numëron softuerët aplikativ;
- Përkufizon kuptimin dhe përdorimin e softuerit për përpunim të tekstit;
- Përshkruan përpunimin dhe formatizimin e tekstit;
- Përshkruan softuerin aplikativ për prezantim;
- Përshkruan krijimin, formatizimin dhe dizajnimin e sllajdeve;
- Tregon aftësi për kryerjen e operacioneve themelore me grafikë dhe diagrame;
- Përkufizon kuptimin dhe përdorimin e softuerin për tabela;
- Përkufizon formula dhe funksione të ndryshme;
- Përshkruan librin e punës (Eörkbook), fletat punuese (sheets) dhe editimin e të dhënave;
- Përshkruan adresimin relativ dhe absolute.

Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësi:

- Shfrytëzon insertimin e objekteve, teksteve në dokument;
- Realizon tabela të ndryshme në dokument;
- Demonstron krijimin, përpunimin e tekstit dhe shtypjen e dokumentit në letër;
- Demonstron kompetencë në përdorimin e disa veçorive më të avancuara në dokument;
- Demonstron aftësi për kryerjen e operacioneve themelore me grafikë dhe diagrame;
- Realizon efekte të ndryshme të paraqitjes së prezantimit;
- Demonstron paraqitjen e prezantimit;
- Demonstron përpunimin, modifikimin dhe formatizimin e të dhënave në tabela;
- Demonstron aktivitete të ndryshme me të dhënat e tabelës;
- Demonstron aktivitete të ndryshme me fletët punuese;

- Demonstron aktivitete të ndryshme me librat punues;
- Përdor formula dhe funksione të ndryshme;
- Demonstron kalkulime të ndryshme me të dhënat e tabelës;
- Demonstron krijimin e grafikut duke u bazuar në të dhënat e tabelës;
- Demonstron krijimin, përpunimin dhe shtypjen e dokumentit në letër.

Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:

- Komunikimi.
- Bashkëpunimi.
- Diskutim.
- Iniciativë për hulumtimin e njohurive të reja.
- Mbledh dhe përpunon informata.
- Të menduarit logjik.
- Shkathësi në zgjidhjen e problemeve.
- Të jetë kritik dhe konstruktiv.
- Punë në grup.
- Punë në dyshe.
- Punë individuale etj.

Kërkesat për vlerësimin e nxënësve:

- Pyetje - përgjigje me shkrim.
- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Listë kontrolli.
- Informata kthyese.
- Teknika e vrojtimit.

Evidentimi i Vlerësimit: informime për punën e nxënësit

- Testi me shkrim duhet të përmbajë pyetje me përgjigje të mbyllur për të verifikuar shkallën e përvetësimit nga çdo nxënës të kriterëve të vlerësimit.
- Testi me shkrim, kombinimi i përgjigjeve të përputhshme, zgjidhjeve të shumëfishta
- Pyetjet me gojë duhet të jenë me përgjigje të hapura.
- Lista e kontrollit duhet të verifikojë aftësinë e nxënësit në krijimin dhe përpunimin e dokumentit, krijimin e prezantimeve të ndryshme dhe për situata të ndryshme duke përdorur efekte të ndryshme të paraqitjes së prezantimit dhe demonstrimin e detyrave të ndryshme projektuese.

Rekomandimet për realizimin e modulit

- Shpjegon softuerin aplikativ.
- Shpjegon përdorimin e softuerit për përpunim të tekstit.
- Shpjegon përpunimin, modifikimin dhe formatizimin e tekstit.
- Shpjegon krijimin, përpunimin dhe shtypjen e dokumentit në letër.
- Tregon kompetencë në përdorimin e disa veçorive më të avancuara në dokument.
- Shpjegon softuerin aplikativ për prezantim.
- Shpjegon krijimin, formatizimin dhe dizajnimin e sllajdeve.
- Tregon aftësi për kryerjen e operacioneve themelore me grafikë dhe diagrame.
- Shpjegon prezantimin.
- Përkufizon kuptimin dhe përdorimin e softuerit për përpunim të tabelave.
- Shpjegon krijimin e librave punues dhe punën me to.
- Shpjegon përpunimin, modifikimin dhe formatizimin e të dhënave në tabela.
- Tregon aktivitete të ndryshme me të dhënat e tabelës.
- Tregon aktivitete të ndryshme me fletët e librit punues dhe me librat punues.
- Tregon kryerjen e kalkulimeve të ndryshme me të dhënat e tabelës.
- Tregon krijimin e grafikut duke u bazuar në të dhënat e tabelës.

- Tregon krijimin, përpunimin dhe shtypjen e dokumentit në letër.

**PËRSHKRUESI I MODULIT
NDËRMARRËSI
Klasa 10**

Titulli i Kualifikimit: Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit

Vlera e Kredive të Modullit: 3 Kredi (35 orë mësimore) në Nivelin 3 të KKK

Niveli i Modullit në KKK: Niveli 3 i KKK

Niveli i Modullit në Strukturën Arsimore: Niveli I i AP

Rezultatet Mësimore (RM) të Modullit: Ndërmarrësi, klasa 10:

RM1: Nxënësi përshkruan kuptimin dhe zhvillimin e ndërmarrësisë

RM2: Nxënësi aftësohet të kuptoj mentalitetin ndërmarrës

RM3 : Nxënësi krijon ide kreative dhe njeh vlerën e tyre

RM1: Nxënësi përshkruan kuptimin dhe zhvillimin e ndërmarrësisë

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruan kuptimin e ndërmarrësisë.
- të identifikoj rolin e ndërmarrësit.
- të identifikon karakteristikat e ndërmarrësisë.
- të identifikon funksionet e ndërmarrësisë.
- të përcaktoj avantazhet e ndërmarrësisë.
- të përcaktoj disavantazhet e ndërmarrësisë.
- të përceptoj mitin mbi ndërmarrësit.
- të dallon punësn me pagë dhe vetëpunësimin.
- të aplikon kreativitet në paraqitjen e vlerave personale,përmes vizatimit me simbole në flipchart
- të aplikon kreativitet në paraqitjen e vlerave personale, shoqërore,vlerat e vendit etj,përmes vizatimit me simbole në flipchart.
- të përshkruaj konceptin e një ndërmarrësi.
- të komunikojë në mënyrë korrekte.
- të jetë bashkëpunues gjatë procesit mësimor.
- të ketë iniciativë për kërkimin e njohurive të reja
- të ketë iniciativë për kërkimin e ideve të reja.

Kushtet e nevojshme:

- Klasë mësimore – kabineti përkatës,
- Tabela e bardhë dhe markeri
- Projektor ,vidio-projektor,.
- Tabela flipçarti
- Kompjuter, printer, fotokopjues, skaner, internet.
- Tekstet mësimore, udhëzuesa, katalogë

Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:

- Ndërmarrësia.
- Karakteristikat e ndërmarrësit.
- Kuptimi i emrit “ndërmarrje”.
- Funksionet e ndërmarrësit
- Avantazhet e ndërmarrësit
- Disavantazhet e ndërmarrësit
- Miti mbi ndërmarrës.
- Dallimi mes punës me pagë dhe vetëpunësimin.
- Kush jam unë.

| |
|--|
| <ul style="list-style-type: none"> - Përcaktimi i vlerave. - Çfarë është një ndërmarrës. |
| <p>Shkathësitë që përvetësohen nga nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të zhvillojë një kuptim të mentalitetit ndërmarrës; - Të zhvillojë një vetëdije për karakteristikat e ndryshme të një ndërmarrësi; - Të kuptojnë praktikën më të mira të zhvillimit të ndërmarrësisë; - Zhvilloj kreativitetin duke nxjerrë një vlerë të shtuar nga burimet ekzistuese. |
| <p>Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi korrekt. - Bashkëpunimi gjatë punës në grupe. - Përvetsimi i informatav. |
| <p>Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:</p> |
| <p>Metodat e Vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje-përgjigje me gojë, të hapura. - Pyetje-përgjigje me gojë, të mbyllura. - Pyetje-përgjigje me shkrim (me zgjedhje të shumëfishtë, me plotësim, me kombinim). - Detyra me shkrim (ushtrime, skica, probleme, ese, vizatime) - Studime të rastit, detyra praktike, hulumtim. - Projekte, kriteret e vlersimit, lojë me role. - Portofolio. |
| <p>Evidentimi i Vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Testi me shkrim do të jetë me përgjigje të mbyllura dhe do të verifikojë shkallën e përvetësimit nga çdo nxënësi të 6-7 kritereve të vlerësimit me karakter teorik. - Pyetje me gojë do të jenë me përgjigje të hapura. - Detyra me shkrim, studime rasti, detyrat praktike, hulumtime, portofolia. |

| |
|---|
| <p>RM2: Nxënësi aftësohet të kuptoj mentalitetin ndërmarrës</p> |
| <p>Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të renditë aftësitë e ndërmarrësit. - të përshkruaj kompetencat e ndërmarrësit. - të paraqes aftësitë e ndërmarrësit si menaxher. - të paraqes aftësitë e ndërmarrësit si drejtues biznesi. - të përshkruaj përfitimet sociale – ekonomik të ndërmarrësisë. - të përshkruaj lidhjen mes ndërmarrjes dhe veprimtarisë njerzore. - të përshkruaj faktorët e veprimtarisë ekonomike. - të përshkruaj faktorët e veprimtarisë jo ekonomike. - të përshkruaj kategoritë e faktorëve të prodhimit. - të aplikon kreativitetin në krijimin e vlerave me produkte – Ndërtimi i Urës. - të diskutohet për faktorët që kontribuojnë në suksesin e ndërmarrësve. - të diskuton me grupin temën e përcaktuar sipas metodës -Ë ord Caffè. - të komunikojë në mënyrë korrekte. - të jetë bashkëpunues gjatë procesit mësimor. - të ketë iniciativë për kërkimin e njohurive të reja - të ketë iniciativë për kërkimin e ideve të reja |
| <p>Kushtet e nevojshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Klasë mësimore – kabineti përkatës, - Tabela e bardhë dhe markeri - Projektor ,vidio-projektor,. - Tabela flipçarti - Kompjuter, printer, fotokopjues, skaner, internet. |

| |
|--|
| <ul style="list-style-type: none"> - Tekstet mësimore, udhëzuesa, katalogë. |
| <p>Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aftësitë ndërmarrëse. - Kompetencat e ndërmarrësit. - Ndërmarrësi si menaxher. - Ndërmarrësi si drejtues biznesi. - Lidhja e ndërmarrjes me përfitimin social ekonomik. - Lidhja mes qëllimeve ndërmarrëse dhe veprimtarive njerëzore. - Veprimtaritë ekonomike. - Veprimtarit jo ekonomike. - Faktorët e prodhimit - Ndërtimi i urës. - Faktorët që kontribuojnë në suksesin e ndërmarrësve. - Ëord Caffè |
| <p>Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vetëbesimin, kreativitetin, shkathtësitë e punës në ekip, përgjegjësi, durim dhe fleksibilitet, guxim për të shqyrtuar dhe eksperimentuar me gjera të ndryshme, shkathtësi të vendimmarrjes dhe zgjidhjes së problemeve, shkathtësi sociale, shkathtësi bashkëpunimi dhe komunikimi, vetëdije për komunitetin lokal. |
| <p>Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi korrekt. - Bashkëpunimi gjatë punës në grupe. - Përvetësimi i informatave. |
| <p>Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:</p> |
| <p>Metodat e Vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje-përgjigje me gojë, të hapura. - Pyetje-përgjigje me gojë, të mbyllura. - Pyetje-përgjigje me shkrim (me zgjedhje të shumëfishtë, me plotësim, me kombinim). - Detyra me shkrim (ushtrime, skica, probleme, ese, vizatime) - Studime të rastit, detyra praktike, hulumtim. - Projekte, kriteret e vlersimit, lojë me role, Portofolio.. |
| <p>Evidentimi i Vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Testi me shkrim duhet të përmbajë pyetje me përgjigje të mbyllur për të verifikuar shkallën e përvetësimit nga nxënësit të 6-8 kriterëve të vlerësimit me karakter teorik. - Pyetje me gojë do të jenë me përgjigje të hapura. - Detyra me shkrim, studime rasti, detyrat praktike, hulumtime, portofolia. |

RM3: Nxënësi krijon ide kreative dhe njih vlerën e tyre.

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruaj faktorin familje si subjekt i ndërmarrjes.
- të aplikon kreativitet në krijimi e vlerave ndërmarrësit të ri, përmes vizatimit në flipchart.
- të prezantoj një ndërmarrës të suksesshëm.
- të bashkëbisedon me (ndërmarrës të suksesshëm, krijues dhe implementues të politikës së zhvillimit të ndërmarrësisë).
- të kuptojnë praktikat më të mira të zhvillimit të ndërmarrësisë.
- të aplikon kreativitet në krijimi e vlerave nga materialet e përcaktuara “ pa vlerë” përmes mjeteve ricikluse
- të prezantoj vlerën e punimit.
- të identifikon iden për mundësin e të qenit ndërmarrës.
- të marr përgjegjësin për qëndrueshmërin, veprimet dhe rreziqet.

- të organizoj kuizin.
- të komunikojë në mënyrë korrekte.
- të jetë bashkëpunues gjatë procesit mësimor.
- të ketë iniciativë për kërkimin e njohurive të reja.

Kushtet e nevojshme:

- Klasë mësimore – kabineti përkatës,
- Tabela e bardhë dhe markeri
- Projektor ,vidio-projektor,.
- Tabela flipçarti
- Kompjuter, printer, fotokopjues, skaner, internet.
- Tekstet mësimore, udhëzuesa, katalogë.

Njohuritë që përvetësohen nga nxënësit:

- Familja si subjekt i ndërmarrjes.
- Karakteristikat e ndërmarrësit të ri.
- Prezentimi i një ndërmarrësi të suksesshëm.
- Krijo vlera me material riciklues.
- A mundem unë të jem ndërmarrës.
- Vendimmarrja.
- Kuizi.

Shkathtësitë që përvetësohen nga nxënësit:

- Vetëbesimin, kreativitetin, shkathtësitë e punës në ekip, përgjegjësi, durim dhe fleksibilitet, guxim për të shqyrtuar dhe eksperimentuar me gjera të ndryshme,shkathtësi të vendimmarrjes dhe zgjidhjes së problemeve, shkathtësi sociale, shkathtësi bashkëpunimi dhe komunikimi,vetëdije për komunitetin lokal.

Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësit:

- Komunikimi korrekt.
- Bashkëpunimi gjatë punës në grupe.
- Përvetsimi i informatave.

Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve:

Metodat e Vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë, të hapura.
- Pyetje-përgjigje me gojë, të mbyllura.
- Pyetje-përgjigje me shkrim (me zgjedhje të shumëfishtë, me plotësim, me kombinim).
- Detyra me shkrim (ushtrime, skica, probleme, ese,vizatime)
- Studime të rastit,detyra praktike, hulumtim.
- Projekte,kriteret e vlersimit,lojë me role.Portofolio.

Evidentimi i Vlerësimit:

- Testi me shkrim duhet të përmbajë pyetje me përgjigje të mbyllur për të verifikuar shkallën e përvetësimit nga nxënësit të 6-8 kriterëve të vlerësimit me karakter teorik.
- Pyetje me gojë do të jenë me përgjigje të hapura.
- Detyra me shkrim, studime rasti, detyrat praktike, hulumtime,portofolia.

PERSHKRUESI I MODULIT
“BAZAT E TURIZMIT”
Klasa 10

Titulli i Kualifikimit: Udhëheqës i hotelit dhe restaurantit

Vlera e Kredive të Modullit: 14 Kredi (140 orë mësimore) në Nivelin 3 të KKK

Niveli i Modullit në KKK: Niveli 3 i KKK

Niveli i Modullit në Strukturën Arsimore: Niveli I i AP

Rezultatet Mësimore (RM) të Modullit “Bazat e turizmit”, klasa 10:

RM1: Nxënësi përshkruan karakteristikat themelore të turizmit

RM2: Nxënësi përshkruan rëndësinë e turizmit për ekonominë e vendit

RM3: Nxënësi përshkruan zhvillimin e turizmit

RM4: Nxënësi përshkruan motivet e udhëtimeve turistike, llojet e turizmit bashkëkohor

RM5: Nxënësi shpjegon faktorët turistikë

RM6: Nxënësi përshkruan vendbanimet turistike

RM7: Nxënësi përshkruan organizimin e turizmit

RM1: Nxënësi përshkruan karakteristikat themelore të turizmit

Kriteret e Vlerësimit të nxënësit: Nxënësi duhet të jetë i aftë të:

- Përshkruan kuptimin dhe rëndësinë e turizmit
- Tregon kuptimin dhe veçoritë e udhëtimeve turistike
- Shpjegon kuptimin për turizmin dhe turistin
- Tregon veçoritë e burimeve turistike dhe masat për mbrojtjen e tyre
- Shpjegon për kuptimin dhe rëndësinë e rekreacioneve turistike

Kushtet e nevojshme:

- Klasa
- Laboratori
- Materiale të shkruara
- Kompjuter Projektor

Njohuritë që përvetësohen nga nxënësi:

- Turizmi dhe turisti
- Udhëtimet turistike
- Rekreacioni dhe turizmi
- Mbrojtja e resurseve turistike

Shkathësitë që përvetësohen nga nxënësi:

- Përshkruan kuptimin dhe rëndësinë e turizmit
- Përshkruan kuptimin dhe veçoritë e udhëtimeve turistike
- Dallon rekreacionin dhe turizmin
- Dallon kuptimin e turizmit dhe turistit
- Përshkruan veçoritë e burimeve turistike, dhe masat për mbrojtjen e tyre

Qëndrimet (sjelljet) që zhvillohen te nxënësi:

- Komunikimi korrekt
- Bashkëpunimi
- Diskutimi
- Iniciativa për hulumtimin e njohurive të reja
- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave dhe informatave
- Të menduarit logjik

| |
|---|
| <ul style="list-style-type: none"> - Shkathtësi në zgjidhjen e problemeve - Të jetë kritik dhe konstruktiv - Punë në grup - Punë në dyshe |
| Kërkesat për Vlerësimin e nxënësve: |
